



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 5202 prot.

Tiranë, më 20.11 2019

VENDIM

Nr. 52, datë 20.11 2019

*Për miratimin e periudhës zgjedhore dhe datës së zgjedhjeve për anëtar të  
Këshillave Studentorë të Fakulteteve të UT*

Bazuar në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 dhe 99, në Statutin e UT neni 31 dhe 133, si dhe në Rregulloren “Për zgjedhjet e para të këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës”, neni 5, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të UT nr.22, datë 26.06.2019, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019;

VENDOSI:

1. Të miratojë periudhën **20 nëntor 2019-17 dhjetor 2019** si periudhë zgjedhore për anëtarë të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës.
2. Të miratojë datën **18 dhjetor 2019** si datë të zgjedhjeve për anëtar të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
PROF.DR. MYNYR KONI

